

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	33-katëshi në Vlorë/ Ardi Kollçaku, marrëveshje me “grupin e kokainës” për “Kullën e Tiranës”
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/26/33-kateshi-ne-vlore-ardi-kollcaku-marreveshje-me-grupi-n-e-kokaines-per-kullen-e-tiranes/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 12:45:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 12:31:11 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2fda7be8dfa6efd6bfe2daf4b0f30cbf202c2dae4fbd58dae94d9eea5a6a4ff
TEKSTI	494eee74af7c7989be2731dd4ce6ed70d843ba26637d4f7737982917db6f0762
PAMJA	aae8bbd8ef104b715428ca4f47b88e8bdb7ac6bfb5a229566aa79699a474d987

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9d9a9d9ea28131aa1c7640cd072aac8e1720c66e56dfb92b35b97b010ee6eb5c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7a6930be9f3749f4980fd84dca137394dacb19a29045da8941f5e341c088ecc2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9d9a9d9ea28131aa1c7640cd072aac8e1720c66e56dfb92b35b97b010ee6eb5c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

3 3-katëshi në Vlorë/ Ardi Kollçaku, marrëveshje me “grupin e kokainës” për “Kullën e Tiranës”

Kryesore

Publikuar: 26/09/2026

f X



Kur u raportua për herë të parë se ish-lojtari i “Big Brother”, Donald Veshaj, kishte aplikuar tek kryeministri Edi Rama për një kullë 33 kate në qendër të Vlorës, rrjeti u përfshi nga dyshimet e forta se ku i gjeti paratë për këtë ndërtim masiv një individ, i cili nuk është dalluar si biznesmen i fuqishëm.

Në mbledhjen e 29 Prillit 2026, Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), nën drejtimin e Ramës, kishte në shqyrtim kërkesën për “Leje zhvillimi për objektin rezidencial dhe hoteleri 33 kate mbi tokë dhe 4 kate nën tokë”, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “DGC” sh.p.k.”.



Në foto (montazh): Kryeministri Edi Rama dhe ish-lojtari i “Big Brother”, Donald Veshaj

Për momentin Ajenicia e Zhvillimit të Territorit (AZHT) nuk ka

Me të lexuarat
Grupi kriminal i AKSHI-t hap klinikë kundër plakjes në emrin e Arlinda Mekos (kontabilistja e ish-shefja e SHISH/ Nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiq të e saj Historia e dyshimtë e ankandit të Llatjas, si u bë Kujtim Llupa pronar i Klubit të Elbasanit Me goditje me pasqyrë, duke më rrezikuar jetën/ Rrëfimi i shefit të Komisaritit të Krajës për v... alarmin: Rusia po përgatit sulme me dronë ndaj Italisë, Spanjës dhe Francës

publikuar informacion nëse kjo kërkesë është miratuar apo refuzuar.

Shoqëria investiture “DGC” është themeluar në shkurt të vitit 2024, me aksionerë Donald Veshaj dhe Glenis Çobo. Pak muaj më vonë, në dhjetor të atij viti, në kompaninë “DGC” shtohet si ortak shoqërië “Anchor Invest”, me ortakun më të rëndësishëm Ardi Kollçaku.

“DGC”, tashmë me tre ortakë, aplikoi për kullën 33 kate në Vlorë. Por, ndërkohë që pritet të mësohet nëse kjo leje është miratuar nga Rama, ortaku kryesor i kompanisë investiture të kullën 33 kate në Vlorë, “Anchor Invest”, po përballet me disa siklete penale.



Në foto: Ardi Kollçaku, ortaku themelues i “Anchor Invest” shpk

Dy ortakët e saj kryesorë, Ardi Kollçaku dhe Albi Shyti, kanë qenë pak ditë më parë subjekt i kontrollit nga ana e agjentëve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, në kuadër të një hetimi që po zhvillon Prokuroria e Posaçme (SPAK) për trafik narkotikësh ndaj një grupi të strukturuar kriminal shqiptar që ka trafikuar tonelata kokainë nga Amerika Latine në drejtim të Europës.

Grupi i kokainës Aliaj-Bibaj

Në 16 Qershor 2026, Prokuroria e Posaçme (SPAK) njoftoi se kishte lëshuar **urdhër-arreste** për disa persona, të dyshuar për “trafik narkotikësh” në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe “pastrim parash”.

Sipas Prokurorisë, grupi i udhëhequr nga një personazh aspak publik, Salvator (Shpëtim) Aliu, dyshohet se ka trafikuar sasi të konsiderueshme lëndër narkotike kokainë nga Ekuadori e vende të tjera të Amerikës së Jugut drejt Belgjikës, Hollandës, Italisë e Britanisë së Madhe.

Gjithashtu, SPAK-un deklaroi se anëtarët e grupit, të identifikuar

si “Aliu-Bibaj”, kanë transferuar në mënyrë të paligjshme dhe kanë pastruar shumë të mëdha parash në sektorin e ndërtimit në Shqipëri.

“Dyshohet se, për të mos tërhequr menjëherë vëmendjen nga strukturat ligjzbatuese, personat nën hetim, orientonin që kompanitë të shfaqeshin fillimisht si nënkontraktore për ndërtim banesash. Në këtë mënyrë, do të “justifikonin” sërish flukset e ardhshme të parave cash dhe shtrirjen e pritshme në sektorin e ndërtimit”, thotë Prokuroria e Posaçme.

Mbi bazën e këtyre dyshimeve, Prokuroria ka sekuestruar një numër shumë të lartë pasurish të paluajtshme të “Aliu Road House” në pronësi të Isa Aliut, vëllait të Salvator Aliut, vila e godina në pronësi të “Altea Invest”, në pronësi të vëllezërve Shpëtim, Sokol e Nikoll Bibaj, si edhe në emër të disa shoqërive të tjera të lidhura me ta.

Paralelisht, Prokuroria e Posaçme ka kryer kontrolle e verifikime edhe në subjekte të tjera private, të cilat rezultojnë se kanë kryer marrëveshje bashkëpunimi me shoqëritë e lidhura me grupin kriminal.

Në listën e kontrollit, siç mëson **“Boldnews.al”**, kanë qenë edhe kompanitë “Anchor Invest”, “Anchor Beton”, si edhe pronarët e administratorët e tyre, Ardi Kollçaku e Albi Shyti.

“Anchor Invest”, kulla e resorte me “grupin e kokainës”

Prokuroria e Posaçme ka evidentuar se në janar të vitit 2022, kompania “Altea Invest” e vëllezërve Bibaj, ka shprehur interes për të bashkëpunuar dhe investuar me 25 përqind (kontribut në para) për ndërtimin e vilave në kompleksin rezidencial “Astoria Residence”, në zonën e Mjull Bathores, në Tiranë.



Në foto: Kompleksi “Astoria Residence” në Mjull Bathore, Tiranë


Ky kompleks është ndërtuar nga shoqëria “Anchor Invest”, me pronarë e administrator Ardi Kollçaku e Albi Shyti, të cilët kanë investuar me 50 përqind, si edhe kanë marrë përsipër procedurat ligjore dhe nxjerrjen e lejeve përkatëse.

Prokuroria e Posaçme, në një njoftim zyrtar, deklaroi se janë vendosur nën sekuestro *“pasuri të paluajtëshme në kompleksi rezidencial vilash në zonën e Mjull Bathores Tiranë, në “Astoria Residence”, të regjistruara në emër të “Altea Invest” të vëllezërve Bibaj, të dyshuar si pjesë e “grupit të kokainës.*

Kulla 34 kate “Tirana Tower”

Bashkëpunimi ndërmjet “Anchor Invest”, e themeluar nga Ardi Kollçaku dhe kompanisë “Altea Invest” të familjes Bibaj, është shtrirë edhe në bashkëpunimin për ndërtimin e një kulle 34 kate të lartë, në rrugën “Xhanfize Keko”, në kryeqyteti, të quajtur “Tirana Tower”.

Në 8 Mars 2023, Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), nën drejtimin e kryeministrit Edi Rama, miratoi *“Lejen e ndërtimit për objektin ‘Strukturë banimi dhe shërbime 1, 8, 9, 33, dhe 34 kate dhe 4 kate nëntokë, në rrugën Xhanfize Keko në Tiranë”, me subjekt zhvilluar shoqërinë “Anchor Invest”.*



Në foto: Leja e ndërtimit për kullën “Tirana Tower”, firmosur nga kryeministri Edi Rama

Rreth një vit para lëshimit të kësaj leje, në janar 2022, kompania “Altea Invest” e vëllezërve Shpëtim, Nikoll e Sokol Bibaj, (në atë

kohë quhej “Bilali” shpk), ka shprehur interesin për të bashkëpunuar dhe investuar me 25 përqind (kontribut në para) për ndërtimin e kompleksit të banimit në rrugën “Xhanfize Keko”, i emërtuar “Tirana Tower”.

Me një marrëveshje të nënshkruar në Shkurt 2024, pra pasi ishte miratuar leja e ndërtimit me firmën e kryeministrit Edi Rama, kompania “Altea Invest” e familjes Bibaj kërkon dhe porosit tek “Anchor Invest” e themeluar nga Ardi Kollçaku, rezervimin dhe ndërtimin e disa pasurive të paluajtshme të llojit apartament, dyqane e poste parkimi tek “Tirana Tower”.